



Н.У. ЦЕНТАР ЗА КУЛТУРА "ИЉО АНТЕСКИ СМОК"-ТЕТОВО
I.K. QENDRA E KULTURËS "ILO ANTESKI SMOK"-TETOVË
N.I. CENTER OF CULTURE "ILO ANTESKI SMOK"-TETOVA

RAPORT VJETOR

PËR PUNË DHE PUNËN

FINANCIARE

Tetovë, 2020



Në bazë të nenit 31-b, paragrafi (1) i Ligjit për Kulturë (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriut” 44/2014) dhe nenit 12, pika 10 të Statutit të IKQK. “Ilo Anteski Smok”-Tetovë, nr. 0101-18/6 të datës 16.04.2015, Drejtori i Institucionit Kombëtar Qendra për Kulturë “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, paraqet:

**RAPORT VJETOR PËR PUNË DHE PUNËN FINANCIARE TË INSTITUCIONIT
KOMBËTAR QENDRA PËR KULTURË
„ILO ANTESKI SMOK”-TETOVË
PËR PERIUDHËN 01/01/2019-31/12/2019**

**TETOVË
2020**



Përmbajtja:

Hyrje.....	4
I. Organet udhëheqëse dhe drejtuese.....	5
I.1. Organ udhëheqës Drejtori	5
I.2. Organ drejtues Këshilli drejtues.....	5
II. Pagesa të realizuara dhe boxhe të shlyera.....	5
III. Pjesa programore.....	7
III.1. Aktivitetet.....	7
III.2. Raport narativ.....	10
IV. Raporti financiar	26
Përfundimi.....	32



HYRJE

Qendra për Kulturë „Ilo Anteski-Smok“-Tetovë është ndërtuar në vitin 1973, ndërsa administrata zyrtarisht me punë filloi në vitin 1975. Objekti ka sipërfaqe prej 6500 m², nga e cila 780 m² janë pjesë e skenës.

Për organizim të aktiviteteve skenike, Qendra për kulturë posedon sallë të madhe me 661 ulëse, si dhe sallë të vogël me 50 ulëse për promovime të ndryshme.

Qendra për kulturë është institucion i rëndësishëm për kulturën, aktivitetet kulturore dhe skenike, të cilat realizohen në qytetin e Tetovës dhe rrethinën në përgjithësi. E gatshme për organizim të koncerteve, aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe skenike, shfaqje, promovime, ekspozita, koncerte të ansambleve, mbajtje të aktiviteteve politike dhe njëkohësisht me veprimet e veta në mënyrë aktive vepron në promovimin dhe realizimin e vlerave kulturore.

Për çdo vit në këtë objekt aktivitetet e tyre i zhvillojnë qindra aktorë të profileve të ndryshme nga të gjitha nacionalitetet dhe gjuhë të ndryshme, aktorë, muzikantë, këngëtarë, kore, fotograf. Në qendrën për kulturë në vit organizohen mbi 100 aktivitete me mbi 50.000 vizitorë.



I.ORGANET UDHËHEQËSE DHE DREJTUESE

I.1.Organ udhëheqës

Drejtori

Drejtori i institucionit për periudhën nga 01.01.2019-31.12.2019 vit, ka udhëhequr, koordinuar dhe ka eliminuar të gjitha pengesat e mundshme, për realizim efikas të aktiviteteve amë, aktiviteteve që organizohen nga shoqata si dhe institucione të ndryshme.

I.2.Organ drejtues

Këshilli Drejtues

Këshillin drejtues të Qendrës për kulturë e përbëjnë 5 përfaqësues të cilët i emëron dhe shkarkon ministri i kulturës, nga të cilët dy janë nga radha e përfaqësuesve nga sfera e kulturës, një është nga pushteti vetë administrimit lokal dhe dy përfaqësues nga të punësuarit në Qendrën për kulturë. Këshilli Drejtues në periudhën nga 01.01.2019-31.12.2019 vit, ka realizuar 2 seanca, të dhëna në mënyrë tabelare.

Data e seancave		Nr. vendimeve	Nr. Pëlqimeve	Nr. Miratimeve
19.03.2019		2	/	/
03.12.2019		3		1
Вкупно:	2	5	/	1

II.PAGESA TË REALIZUARA DHE BORXHE TË SHLYERA

II.I. Aktvendime për realizim të borxheve përmes përmbarueseve

IKQK,,Ilo Anteski-Smok"-Tetovë, më datë 29.03.2019 vit ka të pranuar Aktvendim për lëshim të Urdhëresës për pagesë noteriale nr.64/19 më 22.03.2019 vit, nga ndërmarrja Byroja e Maqedonisë- Shkup, për realizim të borxhit në vlerë prej 12,00.00 denarë, borxh i mbetur nga faturat e pashlyera për shërbimet e buletineve mujorë për të dhëna ekonomike.



Borxhi kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë dhe shpenzimet noteriale në vlerë prej 4,527.00 denarë, më datë 18.04.2018 dhe 01.04.2019 vit, janë paguar nga Qendra për kulturë. Edhe kundrejt pagesës së borxhit kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë dhe shpenzimeve noteriale në vlerë prej 4,527.00 denarë, **procedura për përmba rim është realizuar.**

Në procedurë përmba ruese për borxhin kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë gjithsej është paguar 29,597.00 denarë, nga të cilat kamatë sipas dokumenteve përmba ruese në vlerë prej 2,724.00 denarë dhe shpenzime sipas dokumenteve përmba ruese në vlerë prej 14,873.00 denarë.

Vëmendje: mjetet në vlerë pre 29,597.00 denarë, të cilat janë tërhequr nga Byroja e Maqedonisë Shkup, në procedurë përmba ruese në bazë të Urdhëresës për përmba rim nr.2084/18 më 04.12.2018 vit, të gjithë janë kthyer në xhirollogarinë e Qendrës për kulturë më datë 25.04.2019 dhe 21.05.2019 vit, për shkak se procedura për realizim të borxhit në procedurë përmba ruese në bazë të Urdhëresës për pagesë noteriale, është iniciuar pas pagesës së realizuar nga IKQK., „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë.

II.2. INQK”I.A-Smok”-Tetovë, më 28.10.2019, ka pranuar Urdhëresë për Përmba rim I nr. 1083/19 nga përmba ruesi Slavica Acovska, të sjellë me propozim të kreditorit Ndërmarrja publike komunale Tetovë, për mos shlyerje të borxhit në vlerë prej 622,305.00 denarë, nga ana e Qendrës për kulturë, borxh i mbetur nga mos pagesa e faturave për shërbime komunale. Borxhi është realizuar në procedurë përmba rimi nga llogaria buxhetore edhe atë: borxh kryesor në bazë të dokumenteve të besueshme në vlerë prej 622,305.00 denarë, kamatë bazë të dokumenteve të besueshme në vlerë prej 204,149.00 denarë dhe shpenzime në bazë të dokumenteve të besueshme për përmba rim në vlerë prej 99,462.00 denarë.

II.3. Më datë 19.07.2019, nga ana e kreditorit Urban Plan Konstruktion – Tetovë, në procedurë përmba rimi përmes përmba ruesit Slavica Acovska, nga llogaria buxhetore e INQK “I.A-Smok”-Tetovë, janë realizuar 142,000.00 denarë, në bazë të Urdhëresës për përmba rim I nr.2084/18 më 04.12.2018. Shuma e njëjtë është rikthyer nga ana e kreditorit Urban Plan Konstruktion, në xhirollogarinë vetanake të Qendrës për kulturë, për shkak se përmba rimi është realizuar pas pagesës së borxhit në mënyrë të rregullt nga ana e Qendrës për kulturë.



III. PJESA PROGRAMORE

III.1. AKTIVITETET

IKQK “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, në objektin e vet për paraqitje të aktiviteteve të ndryshme ka sallën e madhe me kapacitet prej 661 ulësesh dhe sallën e vogël të përshtatshme për promovime të ndryshme me 50 ulëse.

Në periudhën prej 01.01.2019 deri më 31.12.2019, në Qendrën për kulturë, gjithsej janë realizuar 104 aktivitete të ndryshme, nga të cilat shumica janë të veprimtarisë së dramës dhe muzikës. Në këto aktivitete, në Qendrën për Kulturë kanë frekuentuar 51.450 dashamirë të artit të të gjitha kombësive dhe religjioneve në vend.

Në bazë të programit vjetor për 2019, janë realizuar dy ekspozita kolektive, dhe atë:

- Ekspozitë kolektive me piktura
- Ekspozitë kolektive me fotografi

Sallën e madhe të Qendrës për Kulturë proporcionalisht e shfrytëzon edhe Teatri i Tetovës, të cilët gjatë këtij viti realizuan 2 premiera, anuluan një trupë të huaj, ndërsa në ditë Teatri i Tetovës shfrytëzoi sallën gjithsej 105 ditë për prova, premiera dhe repriza.

Aktivitetet të ndara sipas llojit për periudhën 01.01.2019–31.12.2019 në mënyrë tabelare duket kështu:

Nr.	LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I AKTIVITETEVE
1.	Shfaqje	34
2.	Muzikë klasike dhe balet	16
3.	Folklor	9
4.	Ekspozita	8
5.	Panaire	0
6.	Tribuna	4
7.	Takime politike	9
8.	Muzikë argëtuese	10
9.	Aktivitete për fëmijë	7
10.	Aktivitete humanitare	1
11.	Film	4
12.	Veprimtari letrare	2
	Gjithsej	104



Sipas kategorisë së moshës:

Nr.	Kategoria e moshës	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	deri 12	14	13.250
2.	+12	10	5.700
3.	+18	80	32.500
	Gjithsej	104	51.450

Aktivitete sipas bazës nacionale

Nr.	Aktivitet sipas përkatësisë nacionale	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	E përzier	37	18.600
2.	Shqiptare	39	20.600
3.	Maqedonase	24	10.350
4.	Serbe	0	0
5.	Turke	2	1.100
6.	Rome	2	800
	Gjithsej	104	51.450

Qendra për Kulturë ka të lidhur kontrata me të gjithë organizatorët, përveç Teatrit të Tetovës, me të cilët jemi nën një kulm. Gjithashtu, duhet të theksojmë se Qendra e Kulturës ka të lidhura kontratë pa pagesë për sallën e madhe dhe foajenë, sipas pëlqimit të marrë nga Qeveria e R. të Maqedonisë dhe Ministrisë së Kulturës për lirim nga pagesa

Nr.	Kontrata të lidhura	Lirim nga pagesa	Vlera
1.	Me leje nga Ministria e Kulturës dhe Qeveria	15 aktivitete	177.000 denarë
2.	Teatri i Tetovës	14 aktivitete (105 ditë)	165.200 denarë
	Gjithsej		342.200 denarë



Dallimi i aktiviteteve për vitin 2018 dhe 2019, tabelarisht duket kështu:

Nr.	LLOJI I AKTIVITETIT	AKTIVITETET 2018	AKTIVITETET 2019
1.	Shfaqje	22	22
2.	Muzikë klasike dhe balet	20	20
3.	Folklor	13	13
4.	Ekspozita	14	14
5.	Panaire	2	2
6.	Tribuna	10	10
7.	Takime politike	6	6
8.	Muzikë argëtuese	4	4
9.	Aktivitete për fëmijë	6	6
10.	Koncerte humanitare	1	1
11.	Aktivitete letrare	3	3
12.	Veprimtari filmike	8	8
	Gjithsej	109	104



III.2. RAPORT NARATIV

Janar 2019

Nuk ka pasur aktivitete

Shkurt 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
folklor	SHKA "Sveti Sava"	09.02.2019	500

01) 09.02.2019 (e shtunë) – Në organizim të SHKA "Sveti Sava" u mbajt koncerti vjetor.
Në aktivitet morën pjesë 500 të pranishëm.

Mars 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
ekspozitë	Komuna e Tetovës	07.03.2019	650
tribunë	Shoqata e pedagogëve shqiptar	07.03.2019	450
shfaqje	Teatri i Tetovës	11.03.2019	450
folklor	Komuna e Tetovës	14.03.2019	650
ekspozitë	Sani Bajrami	18.03.2019	100

01) 07.03.2019 (e enjte) – Në organizim të Komunës së Tetovës, me rastin e Ditës së Mësuesisë, nxënësit e gjimnazit "7-Marsi", realizuan ekspozitë me aktivitete të



realizuara nga vetë nxënësit e kësaj shkolle të mesme. Në këtë aktivitet kishte 650 të pranishëm.

- 02) 07.03.2019 (e enjte) - Me rastin e Ditës së Mësuesisë, Shoqata e Pedagogëve shqiptarë të Maqedonisë, realizoi akademi solemne. Në aktivitet kishte 450 të pranishëm.
- 03) 11.03.2019 (e hënë) – Në hapësirat e sallës së madhe Teatri i Tetovës realizoi reprizën e shfaqjes teatrale “Jashtë bie borë” të autorit Vincenzo Salemme, në regji të Qëndrim Rajanit. Shfaqjen e ndoqën 350 të pranishëm.
- 04) 14.03.2019 (e enjte) - Në organizim të Komunës së Tetovës, SHKA “Jehona e Malësisë së Sharrit”, mbajti koncert vjetor. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 05) 18.03.2019 (e hënë) – Në hapësirat e foajesë u mbajt ekspozitë personale me fotografi të Sani Bajramit. Në aktivitet kishte 100 të pranishëm.

Prill 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
shfaqje	Stand-up show	07.04.2019	450
politike	VMRO	09.04.2019	650
muzikë	Komuna e Tetovës	12.04.2019	650
shfaqje	Teatri i Tetovës	17.04.2019	450
politike	PDSH	18.04.2019	650
politike	BDI	19.04.2019	650
muzikë	Shoqata e pensionistëve	19.04.2019	450
për fëmijë	Shoqata “Kallkan”	20.04.2019	550
shfaqje	SHF “Bratstvo-Migjeni”	22.04.2019	450
tribunë	Medreseja “Isa Beu”	23.04.2019	550
ekspozitë	Medreseja “Isa Beu”	23-24.04.2019	300
muzikë	Shoqata Alegretto	25.04.2019	650
për fëmijë	My Fitness Club	26.04.2019	500



folklor	SHKA “Burimet e Sharrit”	27.04.2019	550
shfaqje	Fakulteti i arteve Universiteti i Tetovës	30.04.2019	50

- 01) 07.04.2019 (e diel) – Në hapësirat e sallës së madhe u realizua shfaqja Stand Up Show, ku morën pjesë 350 shikues.
- 02) 09.04.2019 (e martë) – Në hapësirat e sallës së madhe u mbajt tubim i VMRO-DPMNE-së për Zgjedhjet presidenciale të 2019, ku u paraqit kandidatja prof. dr. Gordana Siljanovska. Në aktivitet kishte 500 pjesëmarës.
- 03) 12.04.2019 (e premte) – Në organizim të shoqërisë “Xheladin Zeqiri” dhe Komunës së Tetovës, në vazhden e agjendës “70 vite Xheladin Zeqiri” u realizua akademja koncertale për nder të 30 vjetorit të legjendarëve Elita 5. Në këtë akademi Komuna e Tetovës i ndau grupit Elita 5 çmimin Ambasadorët e kulturës shqiptare. Koncertin e ndoqën 650 shikues.
- 04) 17.04.2019 (e mërkurë) – Teatri i Tetovës realizoi reprizën e shfaqjes “Jasht bie borë” të autorit Vincenzo Salemme, në regji të Qëndrim Rajanit. Shfaqjen e ndoqën 450 shikues.
- 05) 18.04.2019 (e enjte) - Partia Demokratike Shqiptarëve zhvilloi një takim politik për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 vizitorë.
- 06) 19.04.2019 (e premte) – Në hapësirat e sallës së madhe u mbajt tribuna e Bashkimit Demokratik për Integrim për Zgjedhjet presidenciale të vitit 2019. Në aktivitet morën pjesë 650 vizitor.
- 07) 19.04.2019 (e premte) - Shoqata e pensionistëve mbajti aktivitet muzikor me këngë dhe valle. Gjithsej morën pjesë 6 shoqata pensionistësh nga Maqedonia. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 shikues.
- 08) 20.04.2019 (e shtunë) - Shoqata “Kallkan” nga Tetova realizoi shfaqje recitale në gjuhën turke. Në aktivitet kishte 550 të pranishëm.
- 09) 22.04.2019 (e hënë) – Në sallën e madhe në organizim të shkollës fillore “Bratstvo-Migjeni” u realizua shfaqja e përgatitur nga nxënësit e shkollës. Në aktivitet kishte 450 të pranishëm.
- 10) 23.04.2019 (e martë) – Në organizim të medresesë “Isa Beu” u mbajt koncert dhe recital vjetor. Në aktivitet morën pjesë 550 shikues.
- 11) 23-24.04.2019 (e martë, e mërkurë) – Në hapësirat e foajesë në organizim të medresesë “Isa Beu” u mbajt ekspozitë. Në aktivitet morën pjesë 300 shikues.



- 12) 25.04.2019 (enjte) – Në organizim të shoqatës Alegretto në kuadër të edicionit të shtatë, “Skena e muzikës serioze shqiptare” u realizua konerti “Nata e romancës shqiptare”. Në këtë eveniment performuan: Nita Zenuni (soprano), Besarta Murtezani (soprano), Mustafa Imeri (tenor), Premtim Etemi (dirigjent), dhe Orkestra Rinore e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Mladenski Shqiptarët në Maqedoni. Në aktivitet morën pjesë 650 vizitorë.
- 13) 26.04.2019 (e premte) – Me rastin e 10 vjetorit të ekzistencës, në organizim të klubit të fitnesit My Fitness Club u mbajt edicionin i parë i festivalit të vallëzimit për fëmijëve “Luj Fest”. Në këtë aktivitet morën pjesë 500 vizitorë.
- 14) 27.04.2019 (e shtunë) - Në organizim të SHKA „Burimet e Sharrit”- Tetovë, u mbajt festivali i Folklorit të përpunuar. Në këtë koncert morën pjesë 5 grupe nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Në këtë aktivitet morën pjesë 550 shikues.
- 15) 30.04.2019 (e martë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës dhe Fakultetit të Dramës të Universitetit në Tetovë, u mbajt shfaqja e diplomimit “Kthesa” nga autori Tancred Dorst në regji të Petrit Nezirit. Në këtë aktivitet morën pjesë 450 vizitorë.

Maj 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
tribunë	Medreseja “Isa Beu”	02.05.2019	650
muzikë	Koncert “Jeni Hajat”	03.05.2019	550
shfaqje	“Letečka teatarska trupa”	08.05.2019	400
shfaqje	“Letečka teatarska trupa”	10.05.2019	550
film	Vojvodat-Tetovë	12.05.2019	450
shfaqje	Gjimnazi Kiril Pejçinoviç	16.05.2019	550
shfaqje	Dance House	17.04.2019	350
Për fëmijë	Festivali “Jabollçinja”	18.05.2019	650
muzikë	Shoqata Artal	19.05.2019	600
balet	Studioja e baletit “Menada”	26.05.2019	650
shfaqje	Çerdheja “Mlladost”	31.05.2019	550



- 01) 02.05.2019 (e enjte) – Me rastin e diplomimit të maturantëve, Medresa “Isa Beu” organizoi tribunë për nxënësit dhe prindërit. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 02) 03.04.2019 (e premte) – Në organizim të Shoqatës “Jeni hajat” u mbajt festivali ndërkombëtar “Festa pranverore e Shëngjergjit në Çalikli”. Në këtë aktivitet morën pjesë 550 vizitorë.
- 03) 08.05.2019 (e mërkurë) - Në organizim të Shoqatës “Leteçka teatarska trupa”, u realizua shfaqja për fëmijë “Tregimi i mundshëm-Abrakadabra”. Në aktivitet kishte 400 të pranishëm.
- 04) 10.05.2019 (e premte) - Në organizim të Shoqatës “Leteçka teatarska trupa”, u realizua shfaqja e pestë e “Zhivkova sllava”. Në aktivitet kishte 550 të pranishëm.
- 05) 12.05.2019 (e diel) – Në organizim të tifozeve Vojvoda, në sallën e madhe u bë promovimi i filmit dokumentar “30 vite vojvoda”. Në aktivitet morën pjesë 350 shikues.
- 06) 16.05.2019 (e enjte) – Shkolla e mesme Gjmnazi “Kiril Pejçinoviç” organizoi shfaqje, të cilën e ndoqën 550 shikues.
- 07) 17.05.2019 (e premte) – Në sallën e madhe u realizua prezantimi i shfaqjes së organizuar nga Shoqata për arsim dhe zhvillim “Shtëpia e Valleve” - Tetovë. Në këtë aktivitet morën pjesë 350 vizitorë.
- 08) 18.05.2019 (e shtunë) - Në sallën e madhe u mbajt festivali i këngëve për fëmijë “Jabollçinja”. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 09) 19.05.2019 (e diel) – Në organizim të shoqatës Artal si shfaqje e festivalt “Meridians”, u realizua koncerti i Korit dhe orkestrës së Beshiktashit të Stambollit nga Turqia. Koncertin e dirigjoi Hamdi Demiroglu. Në aktivitet kishte 600 të pranishëm.
- 10) 26.05.2019 (e diel) - Studioja e baletit “Menada”, realizoi premierën me shfaqje baleti me të rinj. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 11) 31.05.2019 (e premte) - Organizuar nga Institucioni Publik Komunal - Kopshti “Mladost” u mbajt koncert dhe recital vjetor për fëmijë. Në këtë aktivitet morën pjesë 550 vizitorë.



Qershor 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
balet	Studio baleti “Menada	02.06.2019	650
film	“Dy gisht mjalt”	05-07.06.2019	1200
muzikë	Shoqata Artal	07.06.2019	650
balet	Studio baleti “Menada”	10-11.06.2019	850
muzikë	Shoqata Artal	13.06.2019	600
muzikë	Shoqata Artal	14.06.2019	550
politike	Partia PEPR	15.06.2019	550
muzikë	TEHO	15-16.06.2019	1100
balet	Shoqata Artal	18.06.2019	650
shfaqje	Тетовски Театар	19.06.2019	650
folklor	SHKA “Branko Çajka”	22.06.2019	500
muzikë	Shoqata Artal	23.06.2019	600
shfaqje	Qendra për gjuhë “Fluent”	24.06.2019	300
ekspozitë	Qendra e Kulturës	28.06.2019	150

- 01) 02.06.2019 (e diel) - Studioja e baletit “Menada”, realizoi premierën me shfaqje baleti me të rinj. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 02) 05-07.06.2019 (e mërtkurë-e premte) – Në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë u shfaq premiera e filmit “Dy gisht mjalt” i regjisorit Emir Halilzade, ku aktrojnë Elvana Gjata dhe Ermal Mamaqi. Në aktivitet morën pjesë 1200 shikues.
- 03) 07.06.2019 (e premte) – Në organizim të shoqatës Artal, në kuadër të festivalit Meridians u realizua shfaqja koncertale e Dajana Malollarit si soprano dhe Laura Lilës në piano. Në koncert kishte 650 të pranishëm.
- 04) 10-11.06.2019 (e hënë, e martë) - Studioja e baletit “Menada”, realizoi premierën me shfaqje baleti me të rinj dhe fëmijë. Në aktivitet kishte 850 të pranishëm.
- 05) 13.06.2019 (e enjte) – Në kuadër të festivalit Meridians, në organizim të shoqatës Artal u mbajt koncerti klasik i Shkëlzen Pajazitit në violinë dhe Shkëlzen Baftiarit



në piano, me mysafirin special në kitarë Jetmir Mehmedin. Në koncert morën pjesë 600 të pranishëm.

- 06) 14.06.2019 (e premte) – Në vazhdimsi të festivalit Meridians, të organizuar nga shoqata Artal, u realizua koncerti solistik i Eriona Dragoiçeës si soprano dhe Pierre Weberit në piano. Në aktivitet ishin të pranishëm 600 dëgjues.
- 07) 15.06.2019 (e shtunë) – Në hapësirat e sallës së madhe u mbajt Kongresi i Partisë për emancipim të plotë të romëve. Në aktivitet morën pjesë 350 të pranishëm.
- 08) 15-16.06.2019 (e shtunë, e diel) - Kori "TEHO" - mbajti Festivalin e 28-të Ndërkombëtar të Këngëve të Korit. Në festival u paraqitën gjithsej 11 kore nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova dhe Bullgaria. Në këtë aktivitet morën pjesë 1100 dëgjues.
- 09) 18.06.2019 (e martë) – Në organizim të shoqatës Artal , në sallën e madhe u realizua shfaqje e Baletit kombëtar të Kosovës “O. TAKA”, në koreografi të Sinan Kajtazit. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 shikues.
- 10) 19.06.2019 (e mërkurë) – Teatri i Tetovës realizoi premierën e komedisë “Nje letër e humbur” të autorit Jon Luka Karaxhale, ne regji të Kushtrim Bekteshit. Në aktivitet morën pjesë 650 shikues.
- 11) 22.06.2019 (e shtunë) – Në organizim të shoqatës së serbëve dhe maqedonëve SHKA “Branko Çajka” u mbajt festivali i dytë tradicional “Lojërat folklorike nën Sharr”. Në aktivitet morën pjesë 500 shikues.
- 12) 23.06.2019 (e diel) – Në organizim të Shoqatës Artal, në kuadër të Festivalit “Meridians”, u mbajt koncerti "Classic & Rock", me performim të: Diana Malollari-vokal, Shkëlzen Pajaziti - violinë, Shkëlzen Baftiari-piano, Jetmir Mehmeti-kitarë , Egzon Leka-bateri dhe Kori i Fëmijëve Artal. Në këtë aktivitet morën pjesë 600 vizitorë.
- 13) 24.06.2019 (e hënë) – Në organizim të qendrës për gjuhë “Fluent” u realizua program artistik me recital dhe shfaqje për fëmijë. Këtë aktivitet e ndoqën 300 shikues.
- 14) 28.06.2019 (e premte) – Si proekt i programit vjetor për 2019 të financuar nga Ministria e Kulturës, në foajenë e Qendrës së Kulturës u mbajt ekspozita kolektive me fotografi të më shumë artistëve. Këtë aktivitet e vizituan 150 adhurues të artit.



Korrik 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
muzikë	Koncert në piano	17.07.2019	500
muzikë (opera)	Komuna e Tetovës	20.07.2019	650
muzikë (opera)	Komuna e Tetovës	28.07.2019	600

- 01) 17.07.2019 (e mërkurë) – Në kuadër të festivalit “Vera e kulturës Tetovare” në organizim të Komunës së Tetovës u mbajt koncert i talentëve të rinj në piano. Në koncert morën pjesë 500 dëgjues.
- 02) 20.07.2019 (e shtunë) – Në organizim të Komunës së Tetovës, në kuadër të festivalit “Vera e kulturës tetovarë” u mbajt koncert me pjesë më të njohura nga operat më të famshme. Koncertin e realizoi tenori i famshëm shqiptar Shkodran Tolaj në përcjellje me piano të Darko Marinovskit. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës Valmir Aziri. Koncertin e ndoqën 650 adhurues të muzikës.
- 03) 28.07.2019 (e diel) – Në organizim të Komunës së Tetovës, në kuadër të festivalit “Vera e Kulturës Tetovarë” u realizua shfaqja operistike “Orfeu dhe Euridika” nga Christoph Willibald në regji të Trajko Jordanovskit. Këtë aktivitet e ndoqën 600 shikues.

Gusht 2019

Nuk ka aktivitete

Shtator 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
shfaqje	Teatri i Tetovës	06.09.2019	400
muzikë	Koncert Jazz Fest	11.09.2019	650



muzikë	Koncert Jazz Fest	12.09.2019	650
muzikë	Koncert Jazz Fest	13.09.2019	600
muzikë	Koncert Jazz Fest	14.09.2019	550
muzikë	Koncert Jazz Fest	15.09.2019	550
Për fëmijë (shfaqje)	"Leteçka teatarska trupa"	23.09.2019	450
shfaqje	"Leteçka teatarska trupa"	24.09.2019	550
shfaqje	Teatri i Tetovës	27.09.2019	600
shfaqje	Teatri i Tetovës	28.09.2019	550
shfaqje	Teatri i Tetovës	29.09.2019	450
shfaqje	Teatri i Tetovës	30.09.2019	500

- 01) 06.09.2019 (e premte) – Në sallën e madhe u realizua repriza e shfaqjes së Teatrit të Tetovës "Jasht bie borë" të autorit Vincenzo Salemme në regji të Qëndrim Rajanit. Në aktivitet morën pjesë 400 shikues.
- 02) 11.09.2019 (e mërkurë) – Si projekt i finansuar nga Ministria e Kulturës u mbajt edicioni i katërt i festivalit "JazzFest-Tetova". Hapjen e festivalit e bëri grupi i famshëm nga Turqia Taksim Trio. Ministri i Kulturës, Hysni Ismaili, mbajti fjalim në hapjen e Edicionit të Katërt të Festivalit të Xhazit në Tetovë. Koncertin e ndoqën 650 dëgjues.
- 03) 12.09.2019 (e enjte) – Në mbrëmjen e dytë të festivalit "JazzFest Tetova" u mbajt Koncerti i vëllezërve me famë ndërkombëtare nga Maqedonie a Veriut Tavitjan Brothers dhe perkusionistit të famshëm nga Maroku Rhani Krija. Këtë aktivitet e ndoqën 650 adhurues të artit.
- 04) 13.09.2019 (e premte) – Në mbrëmjen e tretë të festivalit "JazzFest Tetova" u realizua koncerti Linda Rukaj dhe Band. Në këtë aktivitet kishte 600 të pranishëm.
- 05) 14.09.2019 (e shtunë) – Në mbrëmjen e katërt të festivalit "JazzFest Tetova" performoi kitaristi i njohur Agron. Koncertin e ndoqën 550 dëgjues.
- 06) 15.09.2019 (e diel) – Festivalin u përmbyll me koncertin e artistëve të rinj vendas Nita Reci dhe Quinted. Në këtë aktivitet kishte 550 të pranishëm.



- 07) 23.09.2019 (e hënë) – Në organizim të studios së dramës “Letečka tetarska trupa” u mbajt shfaqja për fëmijë “Tregimi i mundshëm-Abrakadabra”, në regji dhe tekst të Vladimir Jovanovskit. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 450 shikues.
- 08) 24.09.2019 (e martë) - Në organizim të studios së dramës “Letečka tetarska trupa” u mbajt komedia “Zhivkova Sllava” në regji të Vladimir Jovanovskit, e cila paraqet një version tetovar të veprës së mirënjohur “Ivkova Slava” të Strevan Stremacit Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 550 shikues.
- 09) 27.09.2019 (e premte) – Me paraqitjen e shfaqjes “Sfinga e gjallë” nga Teatri kombëtar i Kosovës u hap edicioni i shtatë i “Festivalit ndërkombëtar të Teatrit në Tetovë”. “Sfinga e gjallë” është shfaqje e bazuar në tekstin e Rexhep Qosjës me të njëjtin titull, regjinë e së cilës e ka bërë Blerta Rustemi-Neziraj. Festivalin e shpalli të hapur Ministri i Kulturës Hysni Ismaili. Në aktivitet morën pjesë 600 shikues.
- 10) 28.09.2019 (e shtunë) – Në natën e dytë të festivalit performoi Teatri i dramës së Shkupit me veprën e Paolo Gjenoveze “Të huajt” në regji të Nela Vitosheviqit. Në këtë aktivitet kishte 550 të pranishëm.
- 11) 29.09.2019 (e diel) – Teatri i Tetovës në kuadër të festivalit performoi me reprizën e parë të shfaqjes “Një letër e humbur”, bazuar në veprën e Jon Luka Karaxhales, në regji të Kushtrim Bekteshit. Në aktivitet morën pjesë 450 të pranishëm.
- 12) 30.09.2019 (e hënë) – Në mbrëmjen e katërt të festivalit performuan Albanian Dance Theatar Company nga Tirana me shfaqjen “Unë kam gjithmonë një shami në xhepin tim” në koreografi të Gjergj Pervezit. Në shfaqje kishte 500 të pranishëm.

Tetor 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
shfaqje	Teatri i Tetovës	01.10.2019	600
shfaqje	Teatri i Tetovës	02.10.2019	650
film	TIFF Oda	07-13.10.2019	3200
shfaqje	Teatri i Tetovës	16.10.2019	600
shfaqje	Teatri i Tetovës	18.10.2019	450



literaturë	Ditët e Naimit	19.10.2019	550
politikë	LSDM	22.10.2019	650
shfaqje	“Letečka Teatarska Trupa”	24-25.2019	750
Për fëmijë	Festivali “Jabollëinja”	26.10.2019	650
shfaqje	Teatri i Tetovës	30.10.2019	300
folklor	Ansambli “Tanec”	31.10.2019	450
muzikë	Koncert	31.10.2019	350

- 01) 01.10.2019 (e martë) – Në vazhdimsi të Festivalit të Teatrit, mysafirët nga Turqia, Trupa e Teatrit Atakent nga Stambolli performuan me shfaqjen “Gjiganti me sy blu” në regji të Orhan Kurtuldut. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 600 shikues.
- 02) 02.10.2019 (e mërkurë) – Festivali ndërkombëtar i teatrit në Tetovë u përmbyll me shfaqjen “Zona e lirë” të Teatrit “Migjeni” nga Shkodra, në regji të Fatos Berishës. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 650 shikues.
- 03) 07-13.10.2019 (e hënë-e diell) – Në organizim të TIFF Odës nga Tetova, u mbajt festivali ndërkombëtar i filmit, i cili zgjati një javë. Gjithsejt në festival u shfaqën 19 filma me metrazh të gjatë dhe 83 filma me metrazh të shkurtë. Në festival morën pjesë gjithsej rreth 3.200 shikues.
- 04) 16.10.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës, u realizua premiera e shfaqjes “Bidermani dhe zjarrvënësit” të autorit Maks Frish, në regji të Mehmet Xhelilit. Në këtë aktivitet kishte 600 të pranishëm.
- 05) 18.10.2019 (e premte) – Në organizim të Teatrit të Tetovës, u realizua premiera e dytë e shfaqjes “Bidermani dhe zjarrvënësit” të autorit Maks Frish, në regji të Mehmet Xhelilit. Në këtë aktivitet kishte 450 të pranishëm.
- 06) 19.10.2019 (e shtunë) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u mbajt festivali ndërkombëtar i poezisë “Ditët e Naimit”. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 550 adhurues të poezisë.
- 07) 22.10.2019 (e martë) – Partia Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë mbajti tribunë me qytetarët. Në tribunën morën pjesë 650 qytetarë.
- 08) 24-25.10.2019 (e enjte, e premte) – Studioja e dramës “Letečka teatarska trupa” më 24 tetor realizoi premierën e shfaqjes kamertale “Jeta është e bukur” të Roberto Beninit,



në regji të Elena Bilbilovskës. Shfaqjen teatrale gjithsejt e ndoqën tre repriza në atë dhe të nesërmen. Në këtë aktivitet kishte 750 të pranishëm.

- 09) 26.10.2019 (e shtunë) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u mbajt festivali i këngës për fëmijë “Jabollçinja”. Në festival morën pjesë 19 fëmijë, kurse e ndoqën 650 të pranishëm.
- 10) 30.10.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua repriza e shfaqjes teatrale “Bidermani dhe zjarrvënësit” të autorit Maks Frish, në regji të Mehmet Xhelilit. Në këtë aktivitet kishte 300 të pranishëm.
- 11) 31.10.2019 (e enjte) – Me rastin e 70 vjetorit të ekzistencës së saj, Ansambli “Tanec” realizoi koncertin jubilar “70 vite në hap”. Në koncert ishin të pranishëm 450 pjesëmarës.
- 12) 31.10.2019 (e enjte) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u mbajt koncert solistik i sopranos Fjolla Iseini dhe pianistit Shkëlzen Baftiari. Në koncert kishte 350 të pranishëm.

Nëntor 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
folklor	SHKA “Branko Çajka”	02.11.2019	550
politik	Aleanca për shqiptarët	03.11.2019	650
politik	Bashkimi demokratik për Integrim	03.11.2019	650
shfaqje	Teatri i Tetovës	06.11.2019	400
folklor	SHKA “Burimet e Sharrit”	09.11.2019	550
shfaqje	Teatri i Tetovës	13.11.2019	500
për fëmijë	Spektakël argëtues për fëmijë	15.11.2019	150
folklor	Koncert	16.11.2019	450
shfaqje	Komuna e Tetovës	19.11.2019	650
literaturë	Lidhja e botuesve shqiptar	20-22.11.2019	500
folklor	Albanian Dance Company	20.11.2019	550



shfaqje	Teatri i Tetovës	20.11.2019	500
tribunë	Komuna e Tetovës, Shoqata e pedagogëve shqiptar	22.11.2019	650
muzikë	Komuna e Tetovës Qendra për Kulturë	23.11.2019	650
ekspozitë	Eksp. Pers-Zeqirija Aliji	23.11.2019	150
ekspozitë	Shoqata "Purpura"	26.11.2019	150
muzikë	Qendra për Kulturë	26.11.2019	600
ekspozitë	Ekspozitë personale-Gjylere Dauti	30.11.2019	150

- 01) 02.11.2019 (e shtunë) – SHKA "Branko Çajka" Tetovë organizoi koncert vjetor në seksionin folklorik. Në aktivitet kishte 550 të pranishëm.
- 02) 03.11.2019 (e diel) – Partia politike Aleanca për Shqiptarët Tetovë, në sallën e madhe u mbajt kuvend për zgjedhjen e forumit rinor. Në aktivitet kishte 650 të pranishëm.
- 03) 03.11.2019 (e diel) – Partia politike Bashkimi demokratik për integrim, mbajti tubim të zakonshëm. Në aktivitet ishin të pranishëm 650 pjesëmarës.
- 04) 06.11.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës në bashkëpunim me Fakultetin e arteve në Universitetin e Tetovës, u realizua shfaqja e parë "Tregim Zoologjik" i autorit Edward Albee, në regji të Genc Çajanit. Në aktivitet morën pjesë 400 të pranishëm.
- 05) 09.11.2019 (e shtunë) – Në organizim të SHKA "Burimet e Sharrit" u mbajt festivali i folklorit të përpunuar. Në koncert performuan 5 grupe të ndryshme nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova. Në aktivitet morën pjesë 550 shikues.
- 06) 13.11.2019 (e mërkurë) – Teatri i Tetovës realizoi reprizën e komedisë "Një letër e humbur" të autorit Jon Luka Karaxhale, në regji të Kushtrim Bekteshit. Në aktivitet morën pjesë 500 shikues.
- 07) 15.11.2019 (e premte) – Në kuadër të manifestimit "Tetova feston Nëntorin" u mbajt spektakël argëtues për fëmijë "Edukojmë me art". Në aktivitet kishte 150 të pranishëm.
- 08) 16.11.2019 (e shtunë) – Me rastin e manifestimit "Tetova feston Nëntorin", në sallën e madhe u mbajt premierë koncertale nga Ansambli i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në RMV. Në aktivitet kishte 450 të pranishëm



- 09) 19.11.2019 (e martë) – Në kuadër të manifestimit “Tetova feston Nëntorin”, në orfanzim të Komunës së Tetovës u mbajt monodrama “Apologjia e vërtetë e Sokratit” me legjendarin Mirush Kabashi. Ky aktivitet u ndjek nga 650 të pranishëm.
- 10) 20-22.11.2019 (e mërkurë, enjte) – Në organizim të Lidhjes së botuesve shqiptar të Maqedonisë së Veriut, u realizua edicioni i 15 i “Karnavalit të librit”. Në këtë aktivitet morën pjesë 500 vizitorë.
- 11) 20.11.2019 (e mërkurë) – Në organizim të “Albanian Dance Company”, u realizua shfaqja “Rrokull vetes” një spektakël vallëzimi kontemporan me motive të trashëgimisë kulturore shqiptare. Në këtë aktivitet morën pjesë 550 të pranishëm.
- 12) 20.11.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua shfaqja e aktivitetit “Bidermani dhe zjarrvënësit” të autorit Maks Frish, në regji të Mehmet Xhelilit. Në këtë aktivitet kishte 500 të pranishëm.
- 13) 22.11.2019 (e premte) – Në organizim të Komunës së Tetovës dhe Shoqatës së pedagogëve shqiptar të Tetovës, në kuadër të manifestimit “Tetova feston Nëntorin”, me rastin e ditës së alfabetit u mbajt një akademi solemne. Si pjesë e këtij organizimi u realizua edhe koncerti i pianistes Endra Ademi. Në këtë aktivitet morën pjesë 650 të pranishëm.
- 14) 23.11.2019 (e shtunë) – Në organizim të Qendrës së Kulturës dhe Komunës së Tetovës u realizua festivali këngëve të vjetra qytetare “Teuta”. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe mysafir nga Shqipëria, Kosova dhe nga vendi.. Festivalin u ndjek nga 650 pjesëmarrës.
- 15) 23.11.2019 (e shtunë) – Në foaje u mbajt ekspozitë e muzeut etnologjik të autorit të ndjerë Zeqirija Aliji. Në këtë aktivitet morën pjesë 150 vizitor.
- 16) 26.11.2019 (e martë) – Në organizim të shoqatës “Purpura”, në hapësirat e foajesë u mbajt ekspozita “Të ndryshëm si ju”, ku u ekspozuan piktura të vizatuara nga fëmijët me autizëm. Në këtë aktivitet ishte prezent edhe sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës. Ekspozitën e vizituan 150 persona.
- 17) 26.11.2019 (e martë) – Në kuadër të manifestimit “Tetova feston Nëntorin”, u realizua koncerti “Classic&Rock” si projekt i financuar nga Ministria e Kulturës. Në koncert performuan Shkëlzen Pajaziti, Jetmir Mehmedi, Shkëlzen Baftiari, Egzon Leka dhe Ebrar Mazhar. Në koncert ishin prezent 600 degjues.
- 18) 30.11.2019 (e mërkurë) – Si projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, në foajenë e Pallatit të Kulturës u mbajt ekspozita personale me grafika “Në botën e ritualit” të Gjylere Dautit. Në ekspozitë ishin prezent 150 vizitor.



Dhjetor 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Për fëmijë	Festivali “Bletëzat”	05.12.2019	650
shfaqje	Teatri i Tetovës	06.12.2019	400
politik	PDSH	08.12.2019	650
ekspozitë	Universiteti i Tetovës	10.12.2019	150
shfaqje	Teatri i Tetovës	11.12.2019	400
folklor	SHKA “Xheladin Zeqiri”	12.12.2019	650
film	Milço Mançevski	13.12.2019	500
politik	Alternativa Besa	14.12.2019	650
muzikë	Концепт „Classic&Rock“	17.12.2019	500
shfaqje	Teatri i Tetovës	18.12.2019	500
shfaqje	Komuna e Tetovës	21.12.2019	450
humanitare	Koncert-Eda Zari	21.12.2019	650
shfaqje	Teatri i Tetovës	25.12.2019	300

- 01) 05.12.2019 (e enjte) – Në organizim të Radio Bletës, u mbajt edicioni jubilar i 25-të i festivalit më të vjetër të muzikës për fëmijë në gjuhën shqipe “Bletëzat”. Të pranishmit dhe pjesëmarrësit i përshëndeti Ministri i Kulturës Hysni Ismaili. Në festival morën pjesë 20 fëmijë, ku juria profesionale ndau çmime për më të mirët. Në aktivitet morën pjesë 650 shikues.
- 02) 06.12.2019 (петок) – Në hapësirat e sallës së madhe Teatri i Tetovës realizoi reprizën e shfaqjes teatrale “Jashtë bie borë” të autorit Vincenzo Salemme, në regji të Qëndrim Rajanit. Shfaqjen e ndoqën 400 të pranishëm.
- 03) 08.12.2019 (e diel) – Partia Demokratike Shqiptare, në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës mbajti Kuvend zgjedhor. Në aktivitet morën pjesë 650 anëtar partiak.



- 04) 10.12.2019 (e martë) – Me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Universitetit të Tetovës, u realizua ekspozita me piktura të studentëve të Fakultetit të Arteve. Në aktivitet morën pjesë 150 vizitor.
- 05) 11.12.2019 (e mërkurë) - Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua repriza e shfaqjes teatrale “Bidermani dhe zjarrvënësit” të autorit Maks Frish, në regji të Mehmet Xhelilit. Në këtë aktivitet kishte 400 të pranishëm.
- 06) 12.12.2019 (четврток) – Me rastin e 70 viteve të ekzistencës së saj, në organizim me shoqërinë kulturo artistike “Xheladin Zeqiri” në bashkëpunim me Komunën e Tetovës u mbajt Koncerti jubilar “70 vite Xheladin Zeqiri”. Në aktivitetin e organizuar morën pjesë edhe Krzetarja e Komunës së Tetovës dhe sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës. Koncerti u ndjek nga 650 dëgjues.
- 07) 13.12.2019 (e premte) – Në sallën e madhe u shfaq filmi më i ri “Vrba” i regjisorit më të njohur maqedonas Milço Mançevski. Filmin e përcollën 500 shikues.
- 08) 14.12.2019 (e shtunë) – Në sallën e madhe të Qendrës së Kulturës u mbajt Kuvendi Themelues Zgjedhor i Forumit rinor- Alternativa. Në aktivitet morën pjesë 650 veta.
- 09) 17.12.2019 (e martë) – Si projekt i financuar nga Ministria e Kulturës u mbajr koncerti “Classic&Rock”, ku interpretuan Shkëlzen Pajaziti, Jetmir Mehmedi, Shkëlzn Bafriari, Egzon Leka dhe Ebrar Mazhar. Në koncert kishte 500 të pranishëm.
- 10) 18.12.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës dhe Fakultetit të artit dramatik u realizua rishfaqja e komedisë “Kurora” nga autori Edmund John Millington Sunge në regji të Aferdita Nuhiut. Në aktivitet morën pjesë 500 shikues.
- 11) 21.12.2019 (e shtunë) – Me rastin e 21 dhjetorit, ditës së arsimit në gjuhën turke në Maqedonië u organizua manifestim i posatshëm. Në organizim të shkollës fillore Istikball dhe Komunës së Tetovës, u realizua mbrëmje letrare dhe program kulturor artistike. Në këtë aktivitet kishte 450 të pranishëm.
- 12) 21.12.2019 (e shtunë) – Në iniciativë të këngëtares së mirënjohur të muzikës shqiptare Eda Zari, u organizua koncert humanitar për viktimat e tërmetit në Shqipëri. Në koncert përpos Eda Zarit performuan edhe Visar Kuçi, vëllezërit Tavitjan dhe Friends. Koncetin e ndjekën 650 dëgjues.
- 13) 25.12.2019 (e mërkurë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u realizua repriza e shfaqjes “Një letër e humbur” të autorit Jon Luka Karaxhale, në regji të Kushtrim Bektshit. Në këtë aktivitet kishte 300 të pranishëm.



RAPORTI FINANCIAR

Peruidha prej 01.01.2019 deri më 31.12.2019

TË DALURAT, ZËRI 401 – RROGA BAZË

Të punësuarit të cilët me aktivitetin e tyre kontribuojnë për realizimin e programit vjetor të institucionit, vlera për pagat dhe tatimin personal është 5,596,698.00 denarë.


TË DALURAT, ZËRI 402 – KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË

Detyrimet të cilat rrjedhin nga pagesa e borxheve kundrejt puntorëve për kontributet janë në vlerën gjithsej 2,118,917.00 денари.

TË DALURAT, ZËRI 421 – SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI

Shpenzimert e Qendrës për Kulturë të energjisë elektrike për 6500 m² të hapsirë shfrytëzuese, dhe atë që e shfrytëzon infrastruktura dhe institucionet e tjera si: Teatri i Tetovës, Këndi Amerikan (American Corner Tetovo) janë në vlerë gjithsej 1,399,818.00 denarë. Aktivitetet e liruara nga pagesa nga ana e Ministrisë së Kulturës ndikojnë mbi buxhetin e Qendrës për Kulturë, dyfish më shumë sepse zhvillohen gjatë kohës kur kërkesat për aktivitete janë më të mëdha, aktivitete të cilat përfshijnë 6% të të gjitha aktiviteteve të kësaj periudhe. Teatri i Tetovës dhe Këndi Amerikan shfrytëzojnë hapsira nga ambientete tona si pjese e pandarë, ndaj konstatojmë se mbi 50% të energjisë elektrike i shpenzojnë këta institucione, shpenzime të cilat i bart Qendra për Kulturë. Shpenzimet për energji elektrike, për furnizim me ujë, lëndë djegëse, posta, telefoni, shpenzime të tjera të komunikimit janë gjithsej në vlerë prej 2,948,308.00 denarë.

Nr	Shpenzuesit e energjisë elektrike	%
1	Qendra e Kulturës	40,75
2	Teatri i Tetovës	41,50
3	Këndi Amerikan	11,75
4	Aktivitetet e liruara nga M.K	6,00
	GJITHSEJ	100,00



TË DALURAT, ZËRI 423 – MATERIALET DHE INVENTARI I IMËT

Në kategorinë e shpenzimeve të realizuara për materialet dhe inventarin e imët janë kalkuluar lloje dhe sasi materiali të cilat janë të domostoshme për kryerjen e obligimeve dhe detyrave si, materiale zyre, revista, gazeta etj., produkte ushqimore, materiale për riparime të ndryshme etj. Shpenzimet e këtij zëri janë në vlerë prej 45,001.00 denarë.

TË DALURAT, ZËRI 424 – RIPARIME DHE MIRËMBJATJE RRJEDHËSE

Për riparimet dhe mirëmbajtjen rrjedhëse, shpenzimet janë në vlerë prej 44,444.00 denarë.

TË DALURAT, ZËRI 425 – SHËRBIMET KONTRAKTUESE

Vlera e këtij zëri për pagesë të shpenzimeve për shërbime juridike dhe shërbime të tjera kontraktuese është 56,000.00 denarë.

TË DALURAT, ZËRI 426 – SHPENZIMET TJERA NË VIJIM

Në këtë kategori të të dalurave, shpenzimet për shpallje publike janë në vlerë gjithsej 708.00 denarë.

TË DALURAT, ZËRI 464 – TRANSFERE TË NDRYSHME

Vlera e këtij zëri për qëllime programore është 915,654.00 denarë.



TË DALURAT, ZËRI 465 – PAGESA PËR SHËRBIME PËRMBARIMI

IKQK,,Ilo Anteski-Smok"-Tetovë, më datë 29.03.2019 vit ka të pranuar Aktvendim për lëshim të Urdhëresës për pagesë noteriale nr.64/19 më 22.03.2019 vit, nga ndërmarrja Byroja e Maqedonisë - Shkup, për realizim të borxhit në vlerë prej 12,00.00 denarë, borxh i mbetur nga faturat e pashlyera për shërbimet e buletineve mujorë për të dhëna ekonomike.

Borxhi kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë dhe shpenzimet noteriale në vlerë prej 4,527.00 denarë, më datë 18.04.2018 dhe 01.04.2019 vit, janë paguar nga Qendra për Kulturë. Edhe kundrejt pagesës së borxhit kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë dhe shpenzimeve noteriale në vlerë prej 4,527.00 denarë, procedura për përmbarim është realizuar.

Në procedurë përmbaruese nga xhirrollogarite vetanake për borxhin kryesorë në vlerë prej 12,000.00 denarë gjithsej 29,597.00 denarë, nga të cilat borxh kryesorë sipas dokumenteve përmbaruese 12,000.00 denarë, kamatë sipas dokumenteve përmbaruese në vlerë prej 2,724.00 denarë dhe shpenzime sipas dokumenteve përmbaruese në vlerë prej 14,873.00 denarë.

Mjetet në vlerë pre 29,597.00 denarë, të cilat janë tërhequr nga Byroja e Maqedonisë Shkup, në procedurë përmbaruese në bazë të Urdhëresës për përmbarim nr.64/18 më 22.03.2019 vit, të gjithë janë kthyer në xhirrollogarinë e Qendrës për kulturë më datë 25.04.2019 dhe 21.05.2019 vit, për shkak se procedura për realizim të borxhit në procedurë përmbaruese në bazë të Urdhëresës për pagesë noteriale, është iniciuar pas pagesës së realizuar nga IKQK,,Ilo Anteski-Smok"-Tetovë.

INQK "I.A-Smok"-Tetovë, më 28.10.2019, ka pranuar Urdhëresë për Përmbarim I nr. 1083/19 nga përmbaruesi Slavica Acovska, të sjellë me propozim të kreditorit Ndërmarrja publike komunale Tetovë, për mos shlyerje të borxhit në vlerë prej 622,305.00 denarë, nga ana e Qendrës për kulturë, borxh i mbetur nga mos pagesa e faturave për shërbime komunale. Borxhi është realizuar në procedurë përmbarimi nga llogaria buxhetore edhe atë: borxh kryesor në bazë të dokumenteve të besueshme në vlerë prej 622,305.00 denarë, kamatë bazë të dokumenteve të besueshme në vlerë prej 204,149.00 denarë dhe shpenzime në bazë të dokumenteve të besueshme për përmbarim në vlerë prej 99,462.00 denarë.

Më datë 19.07.2019, nga na e kreditorit Urban Plan Konstruktion – Tetovë, në procedurë përmbarimi përmes përmbaruesit Slavica Acovska, nga llogaria buxhetore e INQK "I.A-Smok"-Tetovë, janë realizuar 142,000.00 denarë, në bazë të Urdhëresës për përmbarim I nr.2084/18 më 04.12.2018. Shuma e njëjtë është rikthyer nga ana e kreditorit Urban Plan



Konstruktion, në xhirollogarinë vetanake të Qendrës për kulturë, për shkak se përmbarimi është realizuar pas pagesë së borxhit në mënyrë të rregullt nga ana e Qendrës për kulturë. Vlera gjithsej e këtij zëri është 1,097,513.00 denarë.

TË DALURAT, ZËRI 482 – OBJEKTE TË TJERA NDËRTIMORE

Në ciklin e investimeve në të cilin përfshihet institucioni jonë si bartës i ndërtimit të objektit të Institucionit Kombëtarë Teatri dhe Biblioteka e Tetovës, në përputhje me Konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Nr. 42-17/184, për periudhën prej 01.01.2019 deri më 31.12.2019 janë realizuar gjithsejt 95,001,023.00 denarë. Për kryerjen e mbyqirjes së objektit të Teatrit dhe Bibliotekës së Tetovës shpenzimet janë në vlerë prej 450,077,00 denarë, ndërsa për realizimin e interiorit janë gjithsej 4,548,900 denarë. Vlera gjithsej e këtij zëri është 100,000,000.00 denarë.

Bashkangjitje: Paraqitja tabelare e Raportit financiar të I.K.Q.K „Ilo Anteski-Smok”

I. TË HYRAT

Zëri	Përshkrimi i Zërit	Vlera (denarë)	Vlera (denarë)	Vlera (denarë)	Gjithsej
		ZËRI 603	ZËRI 631	ZËRI 787	
723911	Qeraja nga objektet	0.00	510,893.00	1,521,797.00	2,032,690.00
741112	Transfere nga buxheti R.M	111,203,793.00	0.00	0.00	111,203,793.00
	Gjithsej të hyra	111,203,793.00	510,893.00	1,521,797.00	113,236,483.00

II. TË DALAT

Zëri	Përshkrimi i Zërit	Vlera(denarë)	Vlera(denarë)	Vlera(denarë)	Gjithsej
		ZËRI 603	ZËRI 631	ZËRI 787	
401	RROGA BAZË	5,596,698.00	0.00	0.00	5,596,698.00
401130	Rroga bazë	5,243,736.00	0.00	0.00	5,243,736.00
401310	Tatimi personal i të ardhurave të rrogës	352,962.00	0.00	0.00	352,962.00



402	KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË	2,118,917.00	0.00	0.00	2,118,917.00
402110	Kontributet bazë të SPI	1,417,359.00	0.00	0.00	1,417,359.00
402210	Kontributet bazë të shëndetësisë	570,382.00	0.00	0.00	570,382.00
402220	Kontributet personale shitesë	38,572.00	0.00	0.00	38,572.00
402310	Kontributet bazë të entit per punsim	92,604.00	0.00	0.00	92,604.00
421	SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA,KOMUNIKACI ONI DHE TRANSPORTI	2,131,832.00	61,225.00	755,251.00	2,948,308.00
421110	Energjia elektrike	1,398,076.00	1,742.00	0.00	1,399,818.00
421120	Uji dhe kanalizimi	115,635.00	0.00	37,787.00	153,422.00
421240	Lëndë djegëse	618,121.00	0.00	699,999.00	1,318,120.00
421310	Posta	0.00	10,114.00	5,448.00	15,562.00
421320	Telefon dhe telefaks	0.00	37,169.00	12,017.00	49,186.00
421390	Shërbime tjera të komunikimit	0.00	12,200.00	0.00	12,200.00
423	MATERIALET DHE INVENTARI I IMËT	0.00	45,001.00	0.00	45,001.00
423110	Materijale për zyrë	0.00	2,400.00	0.00	2,400.00
423120	Revista, gazeta dhe botime të tjera	0.00	12,999.00	0.00	12,999.00
423410	Produkte ushqimore	0.00	6,100.00	0.00	6,100.00
423720	Materijale për riparime të ndryshme	0.00	17,282.00	0.00	17,282.00
423990	Materijale të tjera	0.00	6,220.00	0.00	6,220.00
424	RIPARIME DHE MIRËMBAJTJE RRJEDHËSE	0.00	44,444.00	0.00	44,444.00
424220	Sherbime për sigurimin e objekteve	0.00	44,444.00	0.00	44,444.00
425	SHËRBIME KONTRAKTUESE	0.00	56,000.00	0.00	56,000.00
425310	Shërbime juridike	0.00	28,222.00	0.00	28,222.00
425990	Shërbime të tjera kontraktuese	0.00	27,778.00	0.00	27,778.00



426	SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE	0.00	708.00	0.00	708.00
426410	Publikimi i thirjes publike	0.00	708.00	0.00	708.00
464	TRANSFERE TË NDRYSHME	288,430.00	263,624.00	363,600.00	915,654.00
464990	Transfere të tjera	288,430.00	263,624.00	363,600.00	915,654.00
465	PAGESA PËR SHËRBIME PËRMBARIMI	1,067,916.00	19,000.00	10,597.00	1,097,513.00
465110	Borxhi kryesorë për shërbime përmbarimi	622,305.00	1,403.00	10,597.00	634,305.00
465120	Kamata për shërbime përmbarimi	300,533.00	2,724.00	0.00	303,257.00
465130	Shpenzimet për shërbime përmbarimi	145,078.00	14,873.00	0.00	159,951.00
482	OBJEKTE TË TJERA NDËRTIMORE	100,000,000.00	0.00	0.00	100,000,000.00
482920	Ndërtimi i objekteve të tjera	100,000,000.00	0.00	0.00	100,000,000.00
	GJITHSEJ	111,203,793.00	490,002.00	1,129,448.00	112,823,243.00

I	GJITHSEJ TË HYRA	113,236,483.00
II	GJITHSEJ TË DALA	112,823,243.00
	FITIMI NETO I REALIZUAR MBI TE HYRAT	413,240.00



PËRFUNDIMI

Si përmbledhje e gjithçkaje të lartëpërmendur mund të përmend elementet e mëposhtme:

- Periudha prej më 01.01.2019 - 31.12.2019 Qendra për Kulturë e përfundon me bilans pozitiv të suksesit;
- Planifikimet financiare të shpenzimeve tre mujore te Qendrës për Kulturë nuk janë respektuar plotësisht nga Ministria e Kulturës;
- Administrata e Ministrisë së Kulturës nuk u përmbahet afateve kohore të kërkesave të Qendrës për Kulturë;
- Të gjendet zgjidhje për menaxhimin reciprok me Teatrin e Tetovës për shpenzimet dhe të hyrat për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të gjithë infrastrukturës tonë.
- Të sigurohen fonde financiare nga Ministria e Kulturës për shpenzimet themelore për mirëmbajtjen e vazhdueshme të objektit (renovimi dhe fondet themelore për mirëmbajtjen e higjienës).

I.K.Q.K. "Ilo Anteski-Smok"

U.D.Drejtor

Artan Arslani